



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 19 Shkurt 2022

Nr: 92

VENDIM

PËR

LIRIM DHE EMËRIM TË ANËTARËVE TË KZAZ NR. 21, NR. 22, NR. 23 DHE NR. 24,
QARKU DURRËS

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “ç”, e 2, 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Në bazë të nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, janë kërkuar zëvendësime si më poshtë:

Lëvizja Socialiste e Shqipërisë, me shkresën nr. 1069 prot., datë 19.2.2022, ka kërkuar lirim dhe emërim të anëtarëve të KZAZ nr. 21, nr. 22, nr. 23 dhe nr. 24, qarku Durrës.

Propozimet dhe kandidaturat e paraqitura plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 29, pika 1, shkronja “c”, 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “ç”, e 2, 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

VENDOSI:

1. Të lirojë nga detyra anëtarët e KZAZ nr. 21, z. Agim Maksuti, KZAZ nr. 22, z. Elidon Repçe, KZAZ nr. 23, zj. Borudina Braka dhe KZAZ nr. 24, z. Ervis Vata, qarku Durrës.
2. Të emërojë anëtarët e KZAZ nr. 21, z. Arben Kurmeka, KZAZ nr. 22, zj. Merita Dekovelli, KZAZ nr. 23, z. Edmond Rubiku dhe KZAZ nr. 24, z. Xhevdet Kariçi, qarku Durrës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

